



AGJENCIA E KOSOVËS PËR AKREDITIM
KOSOVO ACCREDITATION AGENCY
AGENCIJA ZA AKREDITOVANJE KOSOVA

Student's Center, 2nd floor, 10000 Prishtina, Kosovo, tel. +381 38 213722, fax +381 38 213087
www.akreditimi-ks.org, email: kaaoffice@gmail.com

Nr. 537/16 Dt. 04.07.2016

Në mbështetje të nenit 145, paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4,21,22 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189), neni 7 (pika 2.3 dhe 4) neni 15 (pika 1, 2 dhe 3) të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037), Udhëzimit Administrativ për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë (Nr. 25/2012), Udhëzimit Administrativ për Themelimin e Agjencisë së Akreditimit të Kosovës (Nr. 11/2004), Udhëzimit Administrativ mbi Kriteret dhe Procedurat për Akreditimin e Shkollave të Larta Profesionale dhe Shkollave të Larta Teknike në Republikën e Kosovës (Nr. 12/2009), dhe Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë, në mbledhjen XXXI-të të mbajtur më 01.07.2014, duke u bazuar në rekomandimin e ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit mori:

V E N D I M

I. Ri-akreditohet programi i studimit të Fakultetit të Edukimit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina":

- Pedagogji e Përgjithshme / BA (180 ECTS)

për periudhën 5 vjeçare, 1 Tetor 2014-30 Shtator 2019

II. Programet e studimit:

- Edukimi dhe Zhvillimi në Fëmijërinë e Hershme / BA (240 ECTS)
- Pedagogji - Drejtimi Teorik-Shkencor / MA (120 ECTS)

akreditohen për periudhën 3 vjeçare, 1 Tetor 2014 - 30 Shtator 2017

Arsyetim

- III. Duke u mbështetur në dispozitat e shënuara më lartë, dhe rekomandimet e ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi..
- IV. Ndaj këtij vendimi lejohet kërkesa për rishqyrtim të vendimi të KSHC-së brenda afatit të paraparë ligjor.
- V. Institucioni i juaj është i obliguar qe të hartojë një Plan të Përmirësimit në bazë të rekomandimeve të dhëna nga Ekipi i ekspertëve (në të dy gjuhët, shqip dhe anglisht dhe në të dy versionet, të shtypur dhe elektronik në CD) dhe të njëjtin ta dorëzoni në Agjencinë e Kosovës për Akreditim deri më 30 Tetor 2014.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakultetit të Edukimit,
- MASHT-it,
- Arkivit

Ferdije Zhushi Etemi, kryetare
Këshilli Shtetëror i Cilësisë

